



VENDIM

Nr.2, Datë 27.01.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
KODIT TË TRANSMETIMIT**

Në mbështetje të neneve 16; 63, pika 1 dhe 110 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Kodit të Transmetimit dhe draftin përkatës,

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a me shkresën nr. 5171/5 Prot., datë 15.12.2015 ka depozituar në ERE për miratim konform neneve 56 gërma 'g' dhe 63, pika 1 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, “Kodin e Transmetimit.“

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e Kodit të Transmetimit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit AHMETI